



LULET DEMOKRATIKE



JEMI NE

DEMOKRACIA DHE TË DREJTAT TONA

LORIKA (13), LORITA (13), AURELA (12), ALMIR (13), SEBIHANE (12), ELLDIN (12)



Ky artikull i punuar nga ne, tregon për demokracinë dhe të drejtat tona si fëmijë. Ju urojmë lexim të mbarë

Ne sot mësuam shumë gjëra. Mësuam për demokracinë, për të drejtat e njeriut, përgjegjësitë tona, etj. Demokracia rrjedh nga fjalët greke „demos“ dhe „kratos“, të cilat në gjuhën shqipe kanë kuptimin e popullit dhe të udhëheqjes. Demokracia ka lindur në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë, në vitin 507 para erës sonë. Kjo formë e parë e demokracisë u quajt demokraci e drejtpërdrejtë. Në këtë formë, populli mbledhjet dhe të gjithë së bashku merrnin vendime. Por gratë, të varfërit dhe të moshuarit, nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në vendimmarrje. Më vonë doli në pah forma e dytë e demokracisë, e cila u quajt demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ka dy sisteme: sistemin parlamentar dhe atë presidencial. Dallimi mes demokracisë së drejtpërdrejtë dhe asaj përfaqësuese është se në demokracinë përfaqësuese, populli


merr vendimet përmes votave, duke zgjedhur deputetët e Kuvendit. Por, kush ka të drejtë të votojë? Të gjithë personat pa marrë parasysh gjininë, racën, fenë, gjendjen ekonomike, apo aftësitë fizike dhe mendore mund të marrin pjesë në zgjedhje dhe të votojnë. I vetmi kusht është që personat duhet të jenë mbi moshën 18 vjeçare.

Ne si fëmijë kemi disa të drejta, e ato janë: e drejta e shkollimit, e drejta e strehimit, e drejta e lojës dhe argëtimit, etj. Njëra prej të drejtave, të cilën e shfrytëzojmë për çdo ditë është e drejta e shkollimit.

Në vendin ku ne jetojmë, në fshatin tonë të gjithë fëmijët shkojnë në shkollë. Shkolla jonë ka fëmijë të ndryshëm, të cilët iu përkasin komuniteteve të ndryshme dhe ata nuk diskriminohen nga askush. Kjo tolerancë mes nesh, sikur elementet e tjera, është element shumë i rëndësishëm i demokracisë dhe ne kështu përiqemi që të forcojmë sa më shumë shtetin tonë.



Nxënësit të cilët shkruajtën këtë artikull



Kështu duket pema e demokracisë

VOTO EDHE TI


FATLIND (10), ANITA (12), ELTA (12), RINOR (12), RILIND (12), GANIMETE (16), GAZMEND (12)

Në grupin tonë ne sot diskutuam për procesin zgjedhor. Ne po ashtu mësuam shumë gjëra të dobishme


Zgjedhja është diçka që e bëjmë çdo ditë, që nga momenti kur zgjohemi në mëngjes. Këto zgjedhje ndodhin pavarësisht moshës. Mirëpo, zgjedhja dhe procesi zgjedhor kanë shumë dallim. Në procesin zgjedhor ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë, të cilët flasin në emrin tonë. Për të marrë pjesë në këtë proces, ne duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Kjo për arsye se procesi zgjedhor kërkon që të jemi të pjekur dhe ta dijmë me saktësi se kush e meriton votën tonë. Vota është fjala e çdo njeriu. Ne votuam edhe në grupin tonë, këtu në „Demos-ti“. Gjithashtu, ne votojmë edhe në klasë, votojmë edhe në lojëra të ndryshme, e nganjëherë edhe në familje. Vota e secilit është sikurse perlat në det. Ato mund të duken njëllor, por secila e ka vlerën e vet të veçantë.



Autorët e artikullit




Zgjedhja është e përditshme. Por, procesi zgjedhor ndodh një herë në katër vjet



Dy llojet e zgjedhjeve në Kosovë janë: zgjedhjet parlamentare (qendrore) dhe zgjedhjet komunale (lokale)



E drejta e votimit mund të gëzohet nga moshja 18 vjeçare



Të gjithë e kemi të drejtën e votës pa dallim race dhe feje

VENDI I PËRFAQËSUESVE TANË

DIONIS (13), BELINDA (12), BLEONA (13), MIMOZA (12), LEONA (10), ADRIJAN (11)



Në këto vizatime janë paraqitur disa funksione të Kuvendit, si dhe të drejtat tona në demokraci

Ne sot biseduam për demokracinë dhe Kuvendin. Gjatë diskutimit, kuptuam se demokracia është qeverisje e popullit. Në demokraci kemi lirinë e të shprehurit, të drejtat e barabarta, tolerancën, respektin si dhe elemente të tjera mjaft të rëndësishme. Mirëpo, edhe pse e kemi lirinë, ne duhet ta shfrytëzojmë këtë element për të mirën e gjithë vendit, dhe nuk duhet të shkaktojmë kaos. Për këtë janë rregullat, të cilat qytetarët duhet t'i zbatojnë dhe t'i respektojnë. Këto rregulla ndryshe njihen si ligje.

Miratimi ose jo miratimi i ligjeve bëhet në Kuvend, i cili është institucioni më demokratik i vendit. Prandaj, njëri ndër funksionet e Kuvendit është funksioni legjislativ. Ne kemi një tjetër institucion, që quhet Qeveria. Ajo përbëhet nga Kryeministri, ministrat dhe zëvendës kryeministrat, por kontrollohet nga deputetët në Kuvend.

Vendi ynë, Kosova është vend demokratik me sistem parlamentar, ku populli në procesin zgjedhor voton kandidatët për deputetë. Këta deputetë janë përfaqësuesit e popullit dhe punojnë në Kuvend, prandaj ky institucion ka funksion përfaqësues. Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, kurse 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë (10 janë serbë, 1 goran, 2 turq, etj). Ndryshe, Kuvendi njihet edhe si „Shtëpia e gjithë popullit“.


Në demokraci të gjithë kemi të drejta të barabarta pa dallim të racës, fesë apo gjinisë. Pra, demokracia neve na mundëson shumë gjëra të mira.



Kuvendi, institucion demokratik



Gazetarët e së ardhmes




E drejta e votës na takon që të gjithëve




Gazetarët e mirë, shkruajnë saktë dhe drejt!



Aurela gjatë punës së saj



Format e demokracisë janë...



Qytetaria aktive



Ne kemi të drejtë të bisedojmë me kandidatët për deputetë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Idriz Seferi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI & VII
Website: www.demos-ti.org Vendi: Strezovc, Kamenicë